




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



MARRËVESHJE
ndërmjet
KOMUNËS SË GJAKOVËS
dhe

NDËRMARRJES PUBLIKE LOKALE KRM “ÇABRATI”

Në kuadër të Granit Komunal të Performancës - Mjedisi i Pastër, që bashkë-financohet nga Qeveria e Kosovës, Bashkimi Evropian dhe Qeveria Gjermane, dhe mbështetet nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ), Komuna është përfituese e mbështetjes financiare që ka për qëllim ngritjen e kapaciteteve në ofrimin e shërbimeve për menaxhim të mbeturinave.

Në kuadër të kësaj mbështetje financiare dhe me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimeve komunale për grumbullim dhe transportim të mbeturinave janë prokuruar asetet e specifikuar në nenin 2 të kësaj Marrëveshje.

Në mbështetje të nenit 12, nenit 14 dhe nenit 17 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisen Lokale, bazuar në nenin 15 të Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina, si dhe në përputhje me kushtet e kontratës për ofrim të shërbimeve për grumbullim dhe transportim të mbeturinave ndërmjet palëve:

PALËT:

- Komuna e Gjakovës, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës Ardian Gjini (tutje ‘Komuna), dhe
- Ndërmarrja Publike Lokale KRM “Çabrati” e përfaqësuar nga Kryeshefi Ekzekutiv Behar Ferizi (tutje KRM “Çabrati”).

lidhin këtë:



MARRËVESHJE

Neni 1

Qëllimi

- 1.1. Qëllimi i kësaj marrëveshje është përcaktimi i kushteve për dhënie në shfrytëzim të aseteve komunale KRM “Çabrati”. Asetet komunale të prokuruar në kuadër të Grantit të Performancës Mjedisi i Pastër dhe të specifikuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshje.

Neni 2

Asetet Komunale

- 2.1. Asetet komunale të specifikuara në pikën 2 të këtij Neni i jepen në shfrytëzim KRM “Çabrati” për periudhën kohore në përputhje me kontratën për ofrim të shërbimeve ndërmjet Komunës dhe Kompanisë Publike dhe nenin 5 të kësaj Marrëveshje.
- 2.2. Asetet komunale që janë prokuruar në kuadër të Grantit të Performancës Mjedisi i Pastër përfshijnë, dy kamion për bartjen e mbeturinave me specifika si në vijim:
 - a) marka: Daimler Truck Mercedes Benz, Tipi: Actros 2033 L 4x2 rotopress 516, Dyrë:2, Ulëse 3, Ngjyra: e bardh, CCM 10677 kw:240; Dizel ;P.bar:7892.00kg, Viti i prodhimit: 2022, Automatik, me numër të Shasis 563459.
 - b) marka: Daimler Truck Mercedes Benz, Tipi: Atego 1524 L 4x2 Variopress 308, Dyrë:2, Ulëse 3, Ngjyra: e bardh, CCM: 7698 kw:175; Dizel;P.bart:4682kg, Viti i prodhimit: 2022, Automatik, me numër të Shasis 546179.

Neni 3

Obligimet e Komunës

- 2.1. Komuna zotohet që me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshje dhe në përputhje me kornizën ligjore të ndjek të gjitha hapat dhe procedurat e nevojshme që asetet e specifikuara në pikën 2 të kësaj Marrëveshje t’i kalojnë në shfrytëzim KRM “Çabrati”.
- 2.2. Komuna zotohet se kjo marrëveshje nuk mund të zbatohet prej, ose të krijoj të drejta për palë të tretë, përpos palëve të specifikuara në këtë Marrëveshje.

Neni 4

Obligimet e KRM “Çabrati”

- 4.1. KRM “Çabrati” zotohet të shfrytëzojë dhe menaxhojë përgjegjshëm asetet e dhëna nën shfrytëzim me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më efikase dhe cilësore për grumbullim dhe transport të mbeturinave sipas kushteve të kësaj Marrëveshje dhe kontratës përkatëse për ofrim të shërbimeve me Komunën.

- 4.2. KRM "Çabrati" ka për obligim që të njoftojë komunën për çdo dëmtim apo aksident i cili mund të ndodhë, respektivisht Sektorin përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave i cili do të mbajë shënime dhe monitoroj gjendjen e pronës Komunale.
- 4.3. KRM "Çabrati" ka për obligim të bëjë regjistrimin e aseteve (kamionëve) në përputhje me kornizën ligjore përkatëse dhe brenda afatit kohor prej 30 ditëve nga data e marrjes së aseteve në shfrytëzim.
- 4.4. KRM "Çabrati" ka për obligim të kryejë mirëmbajtjen dhe servisimin e rregullt të aseteve komunale të specifikuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshje.

Neni 5

Kohëzgjatja

- 5.1. Kjo Marrëveshje lidhet për periudhën kohore nga dita e nënshkrimit deri në përfundim të kontratës së ofrimit të shërbimeve për grumbullim dhe transport të mbeturinave ndërmjet Komunës dhe KRM "Çabrati".
- 5.2. Në rast të shkëputjes së kontratës për ofrim të shërbimeve për grumbullim dhe transport të mbeturinave ndërmjet Komunës dhe KRM "Çabrati", asetet e dhëna në shfrytëzim të përcaktuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshje kalojnë menjëherë nën menaxhim të Komunës.

Neni 6

Zgjidhja e mosmarrëveshjes

- 6.1. Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale t'i zgjedhin me mirëkuptim para se t'i ndjekin procedurat ligjore përkatëse.

Neni 7

Hyrja në fuqi

- 7.1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e palëve nënshkruese.
- 7.2. Me pëlqim paraprak të palëve kjo marrëveshje mund të ndryshohet apo plotësohet.

P A L Ë T

Ardian Gjini



Kryetar i Komunës së Gjakovës

Behar Ferizi



Kryeshet Ekzekutiv i KRM "Çabrati"



Data: 15.07.2022, Vendi: Gjakovë